



Komisioni Regullativ i Prokurimit Publik, duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.6 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik, nxjerrë këtë:

UDHËZUES ADMINISTRATIV Nr.02/2012

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzuesi Administrativ është që të qartësohet baza ligjore për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas nenit 32 paragrafit 4 (**kur pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm**), nenit 35 (**Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës**) dhe nenit 61 (**Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**), sipas Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 2

Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzues Administrativ, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 3

Përgjegjësia e autoritetit kontraktues

Marrja e Vendimit për përdorim të procedurave sipas nenit 32, 35 dhe 61 të këtij ligji është përgjegjësi e plotë e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ të autoritetit kontraktues.

Neni 4

Njoftimi në KRPP

Brenda dy ditë nga data kur është marrë vendimi për përdorim të procedurave të tilla, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i autoritetit kontraktues përkatës do ta dërgojë njoftimin në KRPP me një shpjegim të hollësishëm të fakteve dhe justifikimin për përdorimin e ktyre procedurave, duke plotësuar formularin standard të publikuar në web.faqen e KRPP-së: <http://krpp.rks-gov.net/> sipas nenit 32.5 (Formulari standard B52), sipas 35.1 (Formulari Standard B50) dhe sipas nenit 61 (Formulari Standard B51).

Njoftimin në KRPP, autoriteti kontraktues do ta dërgojë në formë elektronike në e-mail adresën: njoftimekrpp@rks-gov.net, apo në kopje fizike (hard copy) përmes arkivit të KRPP-së dhe menjëherë do të vazhdojë me procedurat e mëtutjeshme të prokurimit.

Neni 5

Ekzaminimi i njoftimeve

KRPP do të mbajë një evidencë të detajuar të këtyre njoftimeve dhe do t'i ekzaminojë raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.4 të këtij ligji lidhur me zbatimin e paragrafit 4 të nenit 32, nenit 35 të këtij ligji.

Neni 6

Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit

Nëse gjatë ekzaminimit të raportit të autoritetit kontraktues, KRPP konstaton se vendimi nuk është marrë në pajtim me nenin në bazë të të cilit ka vendos të përdorë procedurën e prokurimit, KRPP do të marrë iniciativë që të monitorojë aktivitetin e prokurimit në fjalë sipas nenit 87.1 të këtij ligji dhe nëse konstaton se këto procedura janë përdorë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, do t'i ofrojë opinion me shkrim autoritetit kontraktues sipas nenit 87 paragrafit 2, nënparagrafit 2.3 të këtij ligji.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzues Administrativ, hynë në fuqi me 03 Janar 2013.

26 12 2012
(data e nënshkrimit)



[Signature]
Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së